



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	02.05.2024
REFERENC-Ë:	23/5895/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Qazim R. Gashi" B.I Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 23/5985/578/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Qazim R. Gashi" B.I Prishtinë për parkun solar fotovoltaik 1.5 MWp "Babimoc 1", në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitive ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "Qazim R. Gashi" B.I Prishtinë pajiset me **Pëlqim Mjedisor** për veprimtarinë: Parku solar fotovoltaik 1.5 MWp "Babimoc 1", në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq, nën kushtet si vijon:

Gjatë fazës së ndërtimit:

- Gjatë fazës së ndërtimit të parkut solar fotovoltaik 1.5 MWp "Babimoc 1", në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq, të respektohen normat e shkarkimeve në ajër nga automjetet me të cilat transportohen pajisjet e nevojshme si dhe të kontrollohet niveli i zhurmës dhe sasia e pluhurit që krijohen si pasojë e qarkullimit të automjeteve të rënda;

- Gjendja infrastrukture jashtë lokacionit të parkut fotovoltaik 1.5 MWp “Babimoc 1”, në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq e cila përdoret gjatë fazës së ndërtimit duhet të mirëmbahet. Minimizimi i pluhurit në rrugët e transportit duhet të bëhet duke i spërkatur vazhdimisht me ujë.

Gjatë fazës së operimit:

Parku solar fotovoltaik 1.5 MWp “Babimoc 1”, në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq duhet të respektoj:

Emisionet në ajër

- Masat për mbrojtjen e ajrit duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Direktiva për ruajtjen e zogjve të egër 79/409/EC

Menaxhimi mbeturinave

- Menaxhimi i mbeturinave, duhet të bëhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina;



Rastet aksidentale

- Të përgatitet dhe zbatohet plani për raste të aksidenteve mjedisore bazuar në legjislacionin në fuqi;
- Të bëhet rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara, sipërfaqet e rehabilituara të mbjellën me barë duke ju përshtatur mjedisit rrethues;
- Me kushtet e përcaktuara në vendimin e pëlqimit mjedisor operatori detyrohet që pas ndërprerjes përfundimtare të funksionimit të parkut solar fotovoltaik 1.5 MWp “Babimoc 1”, në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq, të planifikoj masat për dekomisionimin dhe për rehabilitimin e vendndodhjes së tij;
- Ndalohet veprimtaria e Kompanisë “Qazim R. Gashi” B.I Prishtinë për parkun solar fotovoltaik 1.5 MWp “Babimoc 1”, në ngastrat kadastrale P-72602001-

00186-27 Babimoc, Obiliq, në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.

- Kompania "Qazim R. Gashi" B.I Prishtinë duhet të instaloj shtresa antirefleksive ne modulet solare duke vendosur qelqe ballore speciale për të ndaluar reflektimin e dritës.
- Kompania "Qazim R. Gashi" B.I Prishtinë për parkun solar fotovoltaik 1.5 MWp "Babimoc 1", në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq, duhet të plotësoj kushtet e parapara në Raportin e VNM-së, për të plotësuar kushtet mjedisore të parapara me Legjislacionin në fuqi.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartëcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).



A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Qazim R. Gashi" B.I Prishtinë për parkun solar fotovoltaik 1.5 MWp "Babimoc 1", në ngastrat kadastrale P-72602001-00186-27 Babimoc, Obiliq, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rekomandim të Komisionit për VNM, nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 te Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Faqe 4 nga 6

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 23/5985/1 - ZSP/ /24 datë: 02.05.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VNM*
3. *Inspektoratit*
4. *Kabinetit të Ministrit*
5. *Komunës së Obiliqit*
6. *Divizionit për komunikim me publikun*
7. *Arkivot të MMPHI*

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI

Faqe 5 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.